



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Raporti i IMPAKTIT

10-VJETORI I FKGGK-së

Gjatë dekadës së fundit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) është konsoliduar si instrument kyç për përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë. Duke ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare, FKGK ka mundësuar kreditimin e bizneseve që përndryshe do të përballeshin me kufizime për shkak të mungesës së kolateralit të mjaftueshëm ose historisë së kufizuar kreditorë, duke mbështetur kështu zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen ekonomike. Përmes veprimtarisë së tij, FKGK ka arritur me sukses t'i përmbushë disa objektiva kryesore zhvillimore:

1. ZGJERIMI I QASJES NË FINANCA:

Ka lehtësuar mbi 1 miliard euro kredi, duke u mundësuar mijëra NMVM-ve qasje në kredi formale, përfshirë edhe një pjesë të konsiderueshme të huamarrësve për herë të parë.

2. PËRMIRËSIME STRUKTURE NË KUSHTET E KREDITIMIT:

Ka ulur kërkesat për kolateral deri në dy të tretat në krahasim me kreditë e pagarantuara, ka zgjatur afatet e maturimit të kredive dhe ka rritur madhësinë e kredive, duke e bërë financimin më të qashtëm dhe më adekuat me nevojat për investime.

3. PROMOVIMI I PËRFSHIRJES FINANCIARE:

Ka rritur qasjen në financa për segmente të nënshërbyera, përfshirë bizneset e udhëhequra nga gratë, ndërmarrjet e reja dhe bizneseve në zonat rurale.

1 USAID ka mbështetur FKGK-në në fazat e hershme përmes ndihmës në hartimin e Ligjit për FKGK-në, themelimin e tij, ekspertizën teknike dhe injektimin fillestar të kapitalit, duke kontribuar në funksionalizimin dhe kapitalizimin e institucionit, si dhe në nënshkrimin e marrëveshjeve të para të garancive me institucionet financiare të regjistruara.

4. MBËSHTETJA E KRIJIMIT TË VENDEVE TË PUNËS DHE RITJES SË BIZNESEVE:

Ka mundësuar zgjerimin e ndërmarrjeve dhe ka kontribuar në rritjen e punësimit në ndërmarrjet e mbështetura.

5. PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE TË SEKTORIT FINANCIAR:

Ka ndikuar që institucionet financiare partnere të zbatojnë qasje më përfshirëse dhe më fleksibile të kreditimit, përfshirë produkte financiare të përshatura dhe kushte më të mira të kredive.

FKGK i ka zbatuar këto objektiva përmes një strategjie të diversifikuar me dritare të targetuara të garancive, duke adresuar sektorë kyçë si bujqësia, eksportet, energjia e ripërtëritshme, bizneset e udhëhequra nga gratë, ndërmarrjet e reja dhe investimet nga diaspora. Kjo qasje i ka mundësuar FKGK-së t'u përgjigjet në mënyrë fleksibile nevojave të tregut, duke mbështetur njëkohësisht fusha strategjike të zhvillimit ekonomik. Ndikimi i tij është fuqizuar më tej nga partneritetet e forta me institucionet financiare, përfshirë bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucione të lizingut, si dhe me partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit, si Qeveria e Republikës së Kosovës, USAID¹, KfW, World Bank, EIB, Sida si dhe DFC. Këto bashkëpunime kanë zgjeruar shtrirjen në treg, kanë forcuar mekanizmin e ndarjes së rrezikut dhe kanë rritur efektivitetin e përgjithshëm të skemës së garancive. Në përgjithësi, FKGK është zhvilluar në institucion kyç zhvillimor, duke kontribuar në një ekosistem financiar më gjithëpërfshirës, më të qëndrueshëm dhe më efikas në Kosovë.

SEKSIONI 1 – INDIKATORËT KYÇË – KCGF NË NJË VËSHTRIM

Arritjet kumulative në shumën e kredive dhe garancive të miratuara

Shuma kumulative e kredive	Shuma kumulative e garancive	Numri kumulativ i kredive	Numri kumulativ i bizneseve
Eur 1.08 miliard	Eur 555 milion	Mbi 21,000	Rreth 12,000

Ndikimi në përfshirjen financiare dhe krijimin e vendeve të punës

Gratë në biznes	Kredimarrës për herë të parë	Vende pune të krijuara në mënyrë indirekte
1,827 gra në biznes të mbështetura, ose 15% e numrit të përgjithshëm të bizneseve të mbështetura janë gra ndërmarrëse.	3,411 klientë të mbështetur për herë të parë, ose 29% e numrit të përgjithshëm të bizneseve të mbështetura.	34,952 vende pune të krijuara, ose 24% rritje në punësim të raportuara nga bizneset.


EUR **109** M
Kapital i Zotuar

Procesimi i kërkesave

Shuma kumulative e kërkesave për pagesë	Numri kumulativ i kërkesave për pagesë	Koha e procesimit të kërkesave për pagesë
Eur 5,2 milion	376	5 ditë


EUR **1.08** Mld
Shuma e kredisë e mundësuar për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM-të)

ZHVILLIMI I FKKG-SË PËRGJATË VITEVE²




² Tabela paraqet shumën e papaguar në dhjetor të secilit vit dhe në shkurt për vitin 2026.


SHUMA KUMULATIVE E GARANCIONEVE TË MIRATUARA SIPAS DRITAREVE GARANTUESE




Shuma kumulative e garancioneve së miratuar sipas sektorit kryesor



Shuma kumulative e garancioneve të miratuara sipas destinimit të kredisë



Shuma kumulative e garancioneve të miratuara sipas madhësisë së biznesit



SEKSIONI 2

KONTRIBUTI I FK GK-SË NË OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (OZHQ)³

Objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm	Performanca e FK GK-së	Ndikimi strategjik dhe kontributi
OZHQ 5: Barazia gjinore	Janë mbështetur 1,827 biznese në pronësi të grave	Garancionet e targetuara kreditore ulin kërkesat joproporcionale për kolateral me të cilat përballen gratë ndërmarrëse, duke promovuar pjesëmarrje të barabartë ekonomike.
	15% e numrit të përgjithshëm të kredive të garantuara u janë disbursuar grave ndërmarrëse	Zgjeron qasjen në financa për bizneset e udhëhequra nga gratë dhe forcon pjesëmarrjen e tyre në ekonominë formale.
	Janë trajnuar 657 gra ndërmarrëse përmes komponentës jofinanciare	Përmes trajnimeve, FK GK ngritë shkathtësitë afariste, njohuritë financiare, shkathtësitë e marketingut digjital dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ndërmarrjeve në pronësi të grave.
	76% e stafit të FK GK-së janë gra	Dëshmon përkushtim institucional ndaj barazisë gjinore dhe përfaqësimit gjithëpërfshirës brenda organizatës.
	35% e bizneseve që kanë marrë kredi për herë të parë janë në pronësi të grave	Përmirëson përfshirjen financiare duke u mundësuar grave qasje në kredi për herë të parë.

³ Ky vlerësim bazohet në të dhënat e shkurtit 2026.

OZHQ 8:
Punë e denjë dhe rritje ekonomike



Përmes garancive kreditore, me normë pjesëmarrjeje prej 25%, janë mbështetur 11,876 biznese nga 48 317 biznese aktive në Kosovë⁴

Dëshmon shkallën e shtrirjes në sektorin privat, duke mbështetur një pjesë të konsiderueshme të bizneseve aktive dhe duke kontribuar në rritjen e ndërmarrjeve, pjesëmarrjen më të gjerë ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

34,952 – rritje e projektuar në punësim nga ndërmarrjet

FKGK kontribuon në krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës duke lehtësuar kreditimin dhe investimet për NMVM-të, gjë që ka mbështetur rritjen e bizneseve dhe rritjen përkatëse të punësimit.

1.08 miliardë euro vëllim kumulativ i kredive

Duke mobilizuar kapitalin privat, FKGK ka nxitur rritjen e BPV-së kombëtare dhe ka formalizuar ekosistemin financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

OZHQ 9:
Industria, inovacioni dhe infrastruktura



40% e kredive janë orientuar për blerjen e teknologjisë, makinerive dhe infrastrukturës

Një pjesë e konsiderueshme e kredive të garantuara është orientuar drejt teknologjisë, makinerive dhe infrastrukturës, për të mbështetur modernizimin industrial dhe për të rritur produktivitetin e NVM-ve.

39 muaj maturitet mesatar i ponderuar

Përmes garancioneve, FKGK mbështetë financim afatgjatë, duke mundësuar shpenzime kapitale të qëndrueshme dhe zhvillim të infrastrukturës në përputhje me ciklet e investimeve.




210.5 milionë euro kredi të dedikuara për prodhim

Pasqyron mbështetje të konsiderueshme për NMVM-të prodhuese, duke forcuar kapacitetin vendor prodhues dhe rritjen industriale. 28% e kredive të dedikuara për sektorin e prodhimit janë garantuar nga FKGK.

46.9 milionë euro mbështetje kreditore për ndërmarrje eksportuese

Promovon konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare, ku 58.3% e financimit për eksport është drejtuar në sektorin e prodhimit.

⁴ Të dhënat për numrin total të bizneseve aktive në Kosovë bazohen në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të cilat gjenden në faqen zyrtare të ASK-së.

OZHQ 10: Ulja e pabarazive 	95% e NMVM-ve kredimarrëse për herë të parë në sektorin bankar, gjatë vitit 2025, janë mbështetur përmes kredive të garantuara nga FKGK ⁵	Zgjeron ndjeshëm përfshirjen financiare duke u mundësuar qasje në kredi bizneseve që më parë nuk janë shërbyer, të cilat hyjnë në sistemin formal financiar të kreditimit për herë të parë.
	52.63% e shpërndarjes së kredive janë jashtë regjionit të kryeqytetit	Promovon zhvillim të balancuar rajonal duke përmirësuar qasjen në financa në zona të pashërbyera dhe rurale, si dhe duke zvogëluar pabarazitë ekonomike gjeografike.
	30% e kredive të garantuara mbi 100 mijë euro janë lëshuar pa asnjë kolateral	Duke mundësuar qasje në kredi me shuma më të mëdha pa kolateral, FKGK ulë barrierat strukturore për kredimarrësit me mungesë kolaterali dhe promovon qasje më të barabartë në financa.
OZHQ 17: Partneritete për qëllime 	109 milionë euro kapital i zotuar	Dëshmon nivel të lartë të kapitalizimit të institucionit dhe i rëndësishëm për ndërtimin e besimit të akterët kyçë të sektorit financiar.
	1.08 miliardë euro kapital privat i mobilizuar për investime të NMVM-ve	Thekson efektivitetin e modelit të garancive në tërheqjen dhe mobilizimin e investimeve nga sektori privat.
	12 institucione financiare partnere	Forcon bashkëpunimin në sektorin financiar dhe mekanizmat e ndarjes së rrezikut, duke promovuar njëkohësisht konkurrencë dhe qasje të barabartë në të gjithë tregun përmes një qasjeje jodiskriminuese, për dallim nga skemat e institucioneve financiare ndërkombëtare supranacionale, të cilat përdorin qasje që favorizon një ose dy ndërmjetës në sektorin bankar.
	8 donatorë dhe partnerë zhvillimi	Forcon bashkëpunimin me qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe qëndrueshmërinë e FKGK-së.
 OZHQ 13: Veprimi për klimën	Ulje e emetimeve të CO ₂ pre 6,610 tonë/vit	Mbështet tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie me emetime të ulëta të karbonit, duke zvogëluar emetimet e gazrave serrë përmes investimeve të gjelbra.
	11,542 MWh/vit kursime të energjisë primare	Promovon efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, duke kontribuar në qëndrueshmëri afatgjatë mjedisore dhe uljen e kostove të energjisë për bizneset.

5 Këto të dhëna janë marrë nga Regjistri i Kredive të Kosovës për vitin 2025.

SEKSIONI 3 – NDIKIMI I FKGK-SË NË KUSHTET E KREDITIMIT

Ky seksion paraqet një analizë krahasuese të kushteve të kreditimit në tregun kreditor të Kosovës në vitin 2025, bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Qëllimi i kësaj analize është të vlerësohet se si performon financimi i mbështetur nga FKGK në raport me sektorin kreditor, sa i përket qasjes në financa, kushteve të kredive dhe dinamikës së ndarjes së rrezikut. Analiza përqendrohet në kreditë deri në 100,000 euro, të cilat përbëjnë mbi 65% të portofolit të FKGK-së dhe segmentin kryesor

të kreditimit të NMVM-ve. Krahasimi i kredive të garantuara dhe atyre të pagantuara brenda këtij intervali shfaq mënyrën se si FKGK adreson barrierat kryesore strukturore, si kërkesat e larta për kolateral, afatet më të shkurtra të maturimit dhe qasjen e kufizuar në financa. Në përgjithësi, gjetjet konfirmojnë se FKGK luan rol thelbësor në përmirësimin e kushteve të kreditimit për NMVM-të dhe forcimin e funksionimit të sistemit financiar.

Pjesëmarrja strategjike dhe shtrirja në treg

FKGK arriti **normë pjesëmarrjeje prej 22.78%**, në sektorin bankar në vitin 2025, duke dëshmuar prani të fortë në tregun e kreditimit të NMVM-ve dhe mbështetjen gjithnjë e më të madhe në mekanizmat e saj të garancisë.


Kategoria e kredisë	Madhësia e kredisë	Shkalla e pjesëmarrjes së FKGK-së (%) në tregun e kredive	Informatë kyçe
Mikro-kreditë	Deri në 10,000 Euro	8.15%	Varësi më e ulët nga garancitë
Kapitali rritës	10,000 deri në 25,000 Euro	16.76%	Varësi më e ulët në garancione kreditore
Zgjerim i masatar	25,000 deri në 50,000 Euro	25.96%	Pjesëmarrje më e lartë. Mbështetje kryesore për zgjerimin e NMVM-ve
Investime në shkallë më të gjerë	50,000 deri në 100,000 Euro	24.32%	Mbështetje e lartë për investime më të mëdha dhe me risk më të lartë
Gjithsej pjesëmarrja në sektor		22.78%	Prani e konsiderueshme në treg e FKGK-së

Ky trend tregon se FKGK është veçanërisht i rëndësishëm në mundësimin e **e investimeve më të mëdha dhe me risk me risk më të lartë të NMVM-ve**, ku kufizimet tradicionale të kredidhënies janë më të larta.

Ulje e kolateralit - Zgjerimi i qasjes në financim

Ulja e kërkesave për kolateral është një nga kontributet më të rëndësishme të FKGK-së në tregun e kredive. Të dhënat e BQK-së tregojnë se kreditë e pagarantuara vazhdojnë të përballen me nivele të larta kolaterali, duke kufizuar qasjen në financim formal.

FKGK ul ndjeshëm kërkesat për kolateral në segmentet kryesore të kredisë:



6 Kalkulohet si diferenca në raportet e mbulimit të kolateralit - e shprehur si përqindje e shumës së kredisë - midis kredive të garantuara nga FKGK dhe kredive të pagarantuara.

Mesatarisht, kreditë e mbështetura nga FKGK-ja kërkojnë rreth **dy të tretat më pak mbulim me kolateral** në krahasim me kreditë e pagarantuara.

Kjo ka disa efekte të rëndësishme:


- Zgjeron qasjen në financa për bizneset e nënshërbyera;
- Ul kostot e kredimarrjes që lidhen me vlerësimin e kolateralit dhe procedurat përkatëse;
- Mundëson miratim më të shpejtë të kredive;
- U lejon ndërmarrjeve që t'i ruajnë asetet e tyre dhe të investojnë në rritje.

Duke rishpërndarë riskun nga kredidhënësit tek fondi i garancioneve, FKGK-ja i inkurajon institucionet financiare të kreditojnë ndërmarrje që nuk kanë kolateral të mjaftueshëm. Qëndrueshmëria e këtyre uljeve të kërkesave për kolateral në madhësi të ndryshme të kredive tregon një **ndikim sistematik në praktikat e kreditimit**, dhe jo vetëm një ndërhyrje marginale.

Ky ndikim në uljen e mbulimit me kolateral konfirmohet edhe nga të dhënat e FKGK-së, sipas të cilave 30% e kredive të garantuara mbi 100 mijë euro janë miratuar pa asnjë kolateral.

Maturitet i zgjatur – Mbështetje për investime afatgjata


Garancitë e FKGG-së përmirësojnë ndjeshëm afatet e maturimit të kredive, duke u mundësuar ndërmarrjeve që t'i përshtatin afatin e shlyerjes së kredisë me ciklet e investimeve. Përparësia në maturitet rritet me madhësinë e kredisë:



Ky maturitet i zgjatur ul presionin e pagesave mujore, ndihmon në përmirësimin e rrjedhës së parasë dhe u mundëson ndërmarrjeve të ndërmarrin **investime më të mëdha dhe më produktive**. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet që kërkojnë kapital më të madh, si zgjerimi i biznesit, blerja e makinerive dhe teknologjisë si dhe investimet që rrisin produktivitetin. Në përgjithësi, maturitetet më të gjata mbështesin rritje më të qëndrueshme të bizneseve dhe forcojnë qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve.

Vëllimi i kreditimit dhe kapaciteti kreditor

FKGK-ja luan gjithashtu rol kyç në rritjen e madhësisë së kredive të disponueshme për NMVM-të. Duke ulur rrezikun për institucionet financiare, skema e garancive mundëson limite më të larta kreditimi.



Kjo rritje e konsiderueshme dëshmon se FKGK-ja u mundëson bizneseve të kenë qasje në **shuma më të mëdha kapitali** se që do të kishin në dispozicion në mungesë të garancionit kreditor, duke mbështetur zgjerimin e bizneseve dhe investimet në shkallë më të gjerë.

Analiza krahasuese tregon se FKGK-ja ka ndikim transformues në kushtet e kreditimit në Kosovë:

- **Lehtëson qasjen në financa** duke ulur barrierat e kolateralit;
- **Zgjeron qasjen në financa për klientë të rinj** në treg, duke krijuar për herë të parë histori kreditore;
- **Përmirëson kushtet e kredive** përmes maturiteteve më të gjata dhe shumave më të mëdha të kredive;
- **Mbështet investime me risk më të lartë dhe të orientuara drejt rritjes;**
- **Ndikon në praktikat e kreditimit në të gjithë sektorin financiar.**

Në përgjithësi, FKGK-ja vepron si ndërhyrje në nivel sistemi, duke përmirësuar qasshmërinë dhe cilësinë e financimit për NMVM-të, duke mundësuar rritje ekonomike më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

SEKSIONI 4 – NDIKIMI I FKGK-së NË PERFORMANCËN E NDËRMARRJEVE

Ky seksion vlerëson ndikimin e garancive kreditore të FKGK-së në performancën e bizneseve, duke përdorur të dhëna nga anketa në nivel të ndërmarrjeve përfshinë ndërmarrjet përfituese dhe ato jopërfituese. Analiza krahason performancën e ndërmarrjeve para dhe pas marrjes së garancive duke mundësuar vlerësimin e ndikimit afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe krahasimin midis ndërmarrjeve të garantuara dhe atyre të pagarantuara. Është e rëndësishme të theksohet se studimi është ballafaquar me sfida në mbledhjen e të dhënave, kryesisht lidhur me disponueshmërinë dhe konsistencën e të dhënave në nivel të ndërmarrjes në të gjithë sektorin. Vështirësitë në qasjen në të dhëna të standardizuara financiare dhe të performancës, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me formalizimin e bizneseve dhe praktikatat e raportimit, mund të ndikojnë në saktësinë e analizës. Dataseti fillestar i të dhënave përfshinte 1,000 ndërmarrje; megjithatë, për treguesit që kanë të bëjnë me performancën e ndërmarrjeve, madhësia e mostrës u reduktua në 239 dhe 113 observime për vitin e parë dhe të dytë pas trajtimit, respektivisht, për shkak të mosdhënies së përgjigjeve, disponueshmërisë së kufizuar të të dhënave dhe boshllëqeve në njohuritë ose raportimin e ndërmarrjeve për indikatorët kyçë të performancës.

Për të adresuar problemin e shtrembërimit të selektimit në garancionet kreditore, studimi aplikon metodologjinë *Inverse Probability Weighted Regression Adjustment* (IPWRA). Rezultatet interpretohen sipas *Average Treatment Effect on Treated* (ATET), duke shfaqur se si do të kishin performuar ndërmarrjet përfituese në mungesë të mbështetjes nga FKGK-ja.

Analiza përqendrohet në indikatorët kryesorë të performancës së ndërmarrjes: punësimi, shitjet, niveli i investimeve dhe produktiviteti (e kalkuluar si shitjet mesatare për punonjës).

GJETJET KRYESORE

Ndikim i theksuar dhe i qëndrueshëm në punësim. Garancionet kreditore kanë efekt pozitiv të qartë dhe statistikisht signifikant në rritjen e punësimit. Ndërmarrjet përfituese nga garancionet kreditore shënojnë rritje më të lartë të punësimit si në afat të shkurtër (me 18% më shumë se një ndërmarrje mesatarisht e njejtë e garantuar), si dhe në afat të mesëm, me (27% më shumë se një ndërmarrje mesatarisht e njejtë e garantuar), duke treguar se ndikimi forcohet me kalimin e kohës. Ky rezultat sugjeron që në mungesë të garancioneve, ndërmarrjet do të kishin përjetuar trende stagnuese ose negative të punësimit.

Ndikimi në treguesit e tjerë të performancës nuk është i qëndrueshëm kur ndërmarrjet e garantuara krahasohen me ndërmarrje të ngjashme të pagarantuara:

- **Shitjet** janë më të larta për ndërmarrjet e garantuara në afat të shkurtër, me efekt modest dhe statistikisht signifikant. Megjithatë, kjo diferencë nuk qëndron gjatë dhe bëhet statistikisht josignifikante në periudhë afatgjatë.
- **Investimet** duken më të larta te ndërmarrjet e garantuara krahasuar me ndërmarrjet e pagarantuara, por diferencat nuk janë statistikisht të rëndësishme në asnjërën periudhë.
- Diferencat në **produktivitet (shitjet për punonjës)**, midis ndërmarrjeve të garantuara dhe atyre të pagarantuara janë negative, duke sugjeruar se ndërmarrjet e garantuara kanë produktivitet më të ulët krahasuar me ato të pagarantuara, megjithëse kjo nuk është statistikisht signifikante.

Tabela 1. Ndikimi i garancive të kredisë në rezultatet e performancës së biznesit (IPWRA - ATET)

Rezultati	Periudha	ATET	Pesha
Punësimi	1-vjet	0.183	***
Punësimi	2-vjet	0.274	**
Shitje	1-vjet	0.601	*
Shitje	2-vjet	0.432	-
Investimi	1-vjet	0.394	-
Investimi	2-vjet	0.958	-
Produktiviteti	1-vjet	-0.655	-

Shënime: ATET = Average Treatment Effect on Treated. Janë raportuar robust standard errors. *** $p < 0.01$, ** $p < 0.05$, * $p < 0.10$, n.s. = statistikisht josignifikante. Modelet kontrollojnë për karakteristikat bazë të ndërmarrjeve dhe variablat e performancës para trajtimit. Rezultatet afatgjata për shitjet dhe investimet duhet të interpretohen me kujdes për shkak të çështjeve të konvergencës. Rezultatet për produktivitetin duhet të interpretohen me kujdes për shkak të problemeve lidhur me identifikimin, ndërsa për vitin e dytë nuk janë arritur rezultate për të njëjtën arsye.

INTERPRETIMI DHE IMPLIKIMET PËR POLITIKA

Rezultatet tregojnë se garancionet e FKGK-së kryesisht mbështesin **zgjerrimin e firmave përmes rritjes së punësimit**, dhe jo medoemos përmirësime të menjëhershme në produktivitet apo performancë. Ky model është në përputhje me objektivin kryesor të FKGK-së për përmirësimin e qasjes në financa dhe mbështetjen e krijimit të vendeve të punës. Në të njëjtën kohë, mungesa e rritjes së ndërmarrjeve në performancë sugjeron se **vetëm qasja në financa nuk mjafton për të nxitur përmirësime në efikasitetin e tyre**. Ndërmarrjet mund të përballen me kosto të përshtatjes gjatë zgjerimit, ndërsa përfitimet në produktivitet mund të kërkojnë më shumë kohë për t'u materializuar. Po ashtu, është e rëndësishme të merret parasysh se FKGK-ja kryesisht mbështet mikrobizneset dhe kredimarrësit për herë të parë, të cilët zakonisht kanë nivele më të ulëta fillestare të produktivitetit, kapacitete të kufizuara menaxheriale dhe luhatshmëri më të madhe në rritje. Si rezultat, këto ndërmarrje mund t'i japin përparësi zgjerimit në punësim përpara përmirësimeve në efikasitet.

PËRFUNDIM

Në përgjithësi, rezultatet e këtij studimi sugjerojnë se FKGK është efektive në zbutjen e kufizimeve kreditore dhe në gjenerimin e rritjes së punësimit, duke konfirmuar rolin e saj si instrument i përfshirjes financiare. Megjithatë, për të forcuar performancën dhe produktivitetin e ndërmarrjeve, garancionet kreditore mund të kenë nevojë të plotësohen me masa shtesë, si mbështetja për inovacion, trajnimet për zhvillimin e shkathtësive dhe qasja e ndërmarrjeve në tregje të reja.

SEKSIONI 5 – FK GK-ja DHE PERSPEKTIVA NË NIVEL EKONOMIE


Ky seksion vlerëson ndikimin e FK GK-së në nivel të përgjithshëm të ekonomisë, duke përdorur kornizën Vector Autoregression (VAR). Analiza vlerëson se si aktiviteti i garancioneve ndikon me kalimin e kohës në ofertën kreditore, investimet, Bruto Produktin Vendor (BPV) dhe kreditë joperformuese. Modeli analizon mekanizmin e transmissioinit përmes të cilit garancionet e FK GK-së ndikojnë në ekonomi, nga oferta kreditore te investimet, prodhimi dhe performanca e kredive. Rezultatet bazohen në Impuls Response Function, të cilat gjurmojnë se si variablat kryesore makroekonomike reagojnë me kalimin e kohës ndaj një goditjeje pozitive në aktivitetin e garancioneve.

GJETJET KRYESORE

NDIKIM I KUFIZUAR NË RRITJEN AGREGATE TË KREDITIMIT

Një goditje pozitive në garancionet e FK GK-së çon vetëm në rritje modeste dhe afatshkurtër të kreditimit të përgjithshëm për biznese. Kjo sugjeron se FK GK-ja kryesisht i riorienton kreditë drejt ndërmarrjeve që përballen me kufizime në qasje në financa, dhe jo medoemos e zgjeron ndjeshëm nivelin e përgjithshëm të kreditimit. Kjo është në përputhje me objektivin e përgjithshëm institucional, sipas të cilit skemat e garancive kreditore nuk synojnë të krijojnë nevojë për kapital/ financim, por të lehtësojnë përmbushjen e nevojës ekzistuese për financim.

Figure 1. KCGF Impulse Response Functions



EFEKT I MENJËHERSHËM NË INVESTIME

Investimet reagojnë në masë të ndjeshme, duke u rritur menjëherë dhe duke arritur kulmin brenda 2–4 tremujorëve. Kjo tregon se kreditimi i garantuar orientohet në mënyrë efektive drejt përdorimeve produktive, duke mbështetur formimin e kapitalit dhe zgjerimin e bizneseve.

NDIKIM POZITIV NË RITJEN EKONOMIKE

BPV-ja rritet me një vonesë kohore, zakonisht duke arritur kulmin pas 3–4 tremujorëve. Kjo pasqyron mekanizmin e transmisionit nga investimet më të larta drejt rritjes së mëvonshme të aktivitetit ekonomik.

PËRMIRËSIM I STABILITETIT FINANCIAR

Kredive joperformuese (Non Performing Loans) bien pas një impulsi të garancioneve, me efektet më të forta që vërehen pas 4–6 tremujorëve. Kjo sugjeron se garancionet kontribuojnë në cilësi të kredive përmes mekanizmit të ndarjes së rrezikut. Aktiviteti i garancioneve ka gjasë të jetë kundërciklik, duke u rritur gjatë periudhave të stresit ekonomik dhe duke u zbutur gjatë periudhave të zgjerimit ekonomik. Kjo thekson rolin e FKGK-së në mbështetjen e rrjedhave të kreditimit kur shtrëngohen kushtet e financimit.

PËRFUNDIM

Në përgjithësi, FKGK funksionon kryesisht si **mekanizëm për shpërndarjen e kredisë dhe ndarjen e rrezikut**, dhe jo si nxitës i zgjerimit agregat të kreditimit. Efektet e saj më të forta vërehen në stimulimin e investimeve, mbështetjen e rritjes së BPV-së dhe përmirësimin e stabilitetit financiar.

Këto gjetje tregojnë se skemat e garancive kreditore mund të gjenerojnë përfitime domethënëse në nivel të përgjithshëm të ekonomisë, veçanërisht në ekonomitë ku qasja në financa është e kufizuar dhe sektori bankar luan rol qendror në ndërmjetësimin financiar.

SEKSIONI 6 – KUFIZIMET

Përkundër performancës dhe ndikimit pozitiv të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), disa barriera strukturore dhe të nivelit të tregut e kufizojnë shkallën në të cilën garancionet kreditore mund t'i adresojnë plotësisht dështimet e tregut që pengojnë zhvillimin e sektorit privat dhe zhvillimin më të gjerë ekonomik. Identifikimi i këtyre kufizimeve është shumë i rëndësishëm për të rritur efektivitetin e skemave të garancive, si dhe për të inicuar zhvillimin e instrumenteve financiare plotësuese që adresojnë më mirë kufizimet financiare dhe mbështesin rritjen e sektorit privat dhe zgjerimin e përgjithshëm ekonomik.

A) TRANSFERIM I KUFIZUAR I PËRFITIMEVE TE PËRFITUESIT E FUNDIT

Ndonëse FKGK ul ndjeshëm riskun për institucionet financiare, optimizimi i mëtejshëm i proceseve ndërmjet FKGK-së dhe ndërmjetësve financiarë mund të përmirësojë bartjen e përfitimeve të kredimarrësit e fundit. Garancitë kreditore janë dëshmuar si instrument efektiv për përmirësimin e qasjes në financa, duke ulur kërkesat për kolateral, duke lehtësuar marrjen e kredisë për herë të parë dhe duke mundësuar afate më të gjata maturimi.

Megjithatë, ndikimi i tyre në uljen e normave të interesit ka qenë modest, pjesërisht si pasojë e riskut relativisht të ulët kreditor në sektor, përkatësisht nivelit të ulët të kredive joperformuese, gjë që e kufizon rolin e riskut si faktor kryesor i kostos në përcaktimin e çmimit të kredive. Përveç kësaj, kërkesat për kolateral mbeten relativisht të larta në disa raste, përkundër mbulimit me garanci kreditore, duke treguar se ka ende hapësirë për përmirësim.

Rekomandim: Të forcohet monitorimi në koordinim me institucionet financiare partnere, për të siguruar që përfitimet e garancive t'u transferohen në mënyrë më të qëndrueshme kredimarrësve dhe për t'i identifikuar më saktë devijimet në praktikën e kreditimit.

B) VETËDIJESIM DHE PËRDORIM I ULËT I INVESTIMEVE TË GJELBRA

Edhe pse ekziston dritare e dedikuar garancie për mbështetjen e projekteve të qëndrueshme mjedisore, niveli i investimeve të gjelbra mbetet i kufizuar. Kjo lidhet pjesërisht me vetëdijen e ulët të ndërmarrjeve, por edhe të institucioneve financiare partnere, lidhur me përfitimet e teknologjive të gjelbra, por edhe me kostot relativisht të larta fillestare që lidhen me investime të tilla. Si rezultat, ende nuk është realizuar plotësisht potenciali i skemës së garancive për të nxitur rezultate të lidhura me investimet e gjelbra.

Rekomandim: Të rritet vetëdijesimi dhe të krijohen stimuj për investime të gjelbra, si dhe të shqyrtohet zhvillimi i produkteve të integruara që kombinojnë skemat e garancive me instrumente të financimit të kombinuar, përfshirë grantet dhe asistencën teknike, me qëllim të zgjerimit të kreditimit të gjelbër. Paralelisht, krijimi i një institucioni të tipit APEX, i cili ofron linja kreditore koncesionale me objektiva me target të qartë, mund të krijojë sinergji me instrumentet e ndarjes së riskut, duke ulur edhe koston e fondeve për ndërmjetësit financiarë, edhe riskun kreditor në nivel transaksioni.

C) ALOKIMI SEKTORIAL DHE MBËSHTETJA PËR BIZNESET NË FAZA TË HERSHME

Pavarësisht niveleve të larta të mbulimit me garanci, deri në 80%, një pjesë e konsiderueshme e financimit vazhdon të orientohet në aktivitete të shërbimeve me vlerë të shtuar të ulët, dhe jo në sektorët më produktivë, si prodhimi apo industrinë e orientuar në eksport. Kjo e kufizon ndikimin e përgjithshëm të skemës në rritjen e produktivitetit dhe në transformimin strukturor ekonomik. Përveç kësaj, përkundër mbështetjes së targetuar përmes dritareve të garancisë për ndërmarrjet start-up, disa institucione financiare vazhdojnë të aplikojnë kërkesa minimale për përvojë biznesi. Kjo e kufizon qasjen në financa për ndërmarrjet e reja, duke ulur efektivitetin e ndërhyrjeve të FKGK-së në promovimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit.

Rekomandim:

- Të vendosen stimuj më të fortë ose instrumente të targetuara për ta orientuar financimin në sektorët me vlerë të shtuar më të lartë dhe në sektorë të orientuar në eksport.
- Të zhvillohen instrumente plotësuese, ose institucione financiare me fokus të orientuar zhvillimor, përtej kreditimit thjesht të orientuar nga profiti, të përshtatura enkas me nevojat dhe profilin e riskut të ndërmarrjeve në faza të hershme.
- Të hartohen politika ekonomike me objektiva të qarta, caqe të matshme dhe afate të përcaktuara kohore për adresimin afatgjatë të sfidave strukturore të ekonomisë.

D) KUFIZIMET NË TË DHËNA DHE SFIDAT E MONITORIMIT

Procesi i vlerësimit kufizohet nga qasja e kufizuar në të dhëna gjithëpërfshirëse, të standardizuara dhe të qasshme në të gjithë sektorin financiar. Sfidat që kanë të bëjnë me formalizimin e ndërmarrjeve, cilësinë dhe konsistencën e të dhënave e zvogëlojnë mundësinë për t'i gjurmuar dhe verifikuar plotësisht rezultatet kryesore, si punësimi dhe gjenerimi i të hyrave. Kjo e kufizon thellësinë dhe saktësinë e vlerësimit të ndikimit dhe të monitorimit të vazhdueshëm.

Rekomandim:

- Të krijohet një taksonomi kombëtare e të dhënave me qëllim për të siguruar harmonizimin e standardeve të të dhënave nëpër sektorë dhe institucione.
- Të forcohet shkëmbimi i të dhënave dhe koordinimi ndërmjet institucioneve, përfshirë të gjitha institucionet që konsiderohen mbledhëse të të dhënave, si dhe të përmirësohet qasja në të dhënat e agjencive përkatëse publike për qëllime analitike dhe politikëbërëse. Kjo mund të mbështetet përmes zhvillimit të një platforme të centralizuar për mbledhjen e të dhënave dhe integrimin më të madh të bazave të të dhënave ndërmjet institucioneve qeveritare, duke mundësuar shkëmbim më efikas të të dhënave dhe monitorim më të mirë. Forcimi i sistemeve të të dhënave është thelbësor për hartimin e politikave publike, duke mundësuar targetim më të mirë, vlerësim më të saktë dhe përmirësim të vazhdueshëm të politikave dhe instrumenteve zhvillimore.



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND



www.fondikgk.org